



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 6/1 Prot.

Tiranë, më 6/9/2010

Lënda: Rekomandim mbi inspektimin administrativ të zhvilluar pranë kontrolluesit Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit (Komisariati i Policisë Aeroporti Rinas).

Drejtuar: Komisariati i Policisë Kufitare Rinas pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë.

Adresa: Rinas

TIRANË

Më datë 24.08. 2010 nga grupi i inspektimit të zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë jush, me cilësinë si kontrollues që mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit tuaj, me objekt:

- Në zbatim të statusit të veçantë të këtij kontrolluesi: A njihet ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe ç’masa janë marrë për implementimin e tij.
- Ç’farë të dhënash përpunoni (të dhëna personale, që prekin privatësinë, sensitive, biometrike etj). Nëse përpunimi i tyre bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private (neni 2).
- Për këto të dhëna a zbatohen kriteret e nenit 5, të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Nëse ka instalime të kamerave, a përdoren ato sipas udhëzimit të Komisionerit veçanërisht nëse për përdorimin e tyre a ka paralajmërime.
- Ç’masa merren për sigurinë e të dhënave personale. Ku mbahen të dhënat dhe sa është koha e mbajtjes së tyre.
- Nëse kanë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose rregulla që janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme.
- A njihen të drejtat e subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe si zbatohen këto të drejta

- Nëse dhe në ç'masë zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi aktet (relacionin, procesverbalin e inspektimit administrativ, etj) të mbajtura me këtë rast, si dhe provat e administruara konstaton:

- 1) Kontrolluesi Komisariati i Policisë Kufitare Rinas pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë. nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 - Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.
- 2) Kontrolluesi Komisariati i Policisë Kufitare Rinas mban dokumente, regjistra dhe evidenca të ndryshme, të cilat përmbajnë të dhëna personale, për një kohë me të gjatë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar.
 - Nuk është zbatuar neni 5 pika 1 germa "d" e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" "...në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të t dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej". Nuk është zbatuar neni 27 pika 4 e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"..." Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar"
- 3) Kontrolluesi nuk ka të vendosura tabela paralajmëruese për përdorimin e kamerave të videosurvejimit në ambientet e Komisariatit dhe në rrugën hyrëse të tij.
 - Nuk është zbatuar neni 18 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"..." Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave".

Këto shkelje janë provuar me:

- Provat e administruara gjatë inspektimit administrativ si:
 - Kopje të listës së pasagjerve të arshivuar pranë kontrolluesit
 - Një kopje të formularit që plotësohej nga personat e kthyer
 - Leje kalimi shtetasve

- Intervistimet e kryera me përfaqësuesit e kontrolluesit
- Investigimet dhe këqyrjet e realizuara në ambientet e kontrolluesit (sekretari, arshivë, salla operative, gabinat në terminal, ambientet përreth kontrolluesit etj)

Për përmirësimin e gjendjes mbështetur në nenet 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Komisioneri rekomandon këto masa:

1. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, brenda datës 30 Shtator 2010 të plotësojë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të vendosë tabelat paralajmëruese për përdorimin e sistemit të videosurvejimit.
3. Në kuadër të bashkëpunimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për hartimin e rregullores së brendshme “Për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave” kërkojmë nga ju të jepni kontributin tuaj në procesin në vazhdim për hartimin e kësaj rregullore.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej tre muaj.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

